




HAPJA E EKSPozITËS ME PRODUKTET E ASIG NDËR VITE

Me rastin e 10 vjetorit të krijimit të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në ambientet e Qendrës për Teknologjitë Kreative, Tiranë, më datë 14 nëntor 2023, u çel ekspozita me produkte të realizuara nga ASIG ndër vite. Ky aktivitet u hap me fjalën e mirëseardhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG znj. Vilma Tomço, dhe u nderua me pjesëmarrjen e Zëvendëskryeministrit të Shqipërisë, znj. Belinda Balluku, e cila në fjalimin e saj përshëndetës mbështeti nismat dhe rezultatet e arritura të ASIG. Në këtë aktivitet u paraqitën harta të ndryshme, ortofoto të reja dhe historike, harta të krijuara nga analizimi i imazheve satelitore hiperspektrale dhe multispektrale, instrumente dhe pajisje të përdorura nga ASIG ndër vite etj.. Ekspozita pati një interes të gjerë përgjatë periudhës 3 ditore që qëndroi e hapur nga aktorë të ndryshëm të sektorit publik, privat si dhe botës akademike.



Mapathon

Në kuadër të 10 vjetorit të krijimit të ASIG, më datë 14 nëntor 2023 u zhvillua aktiviteti Mapathon me nxënës të shkollave të mesme, që kishte për qëllim njohjen e nxënësve me hartat, funksionin, qëllimin e përdorimit të tyre, njohjen me Gjeoportalin Kombëtar dhe si mund ta përdornin për funksione të ndryshme. Në këtë aktivitet morën pjesë 9 shkolla të mesme të përgjithshme dhe profesionale të Tiranës. Juria shpalli fitues të këtij konkursi shkollën "Sami Frashëri".



GIS Day

Në datën 15 Nëntor 2023, u zhvillua aktiviteti GIS Day për Ditën e GIS-it Ndërkombëtar. Përgjatë këtij aktiviteti u zhvilluan leksione të hapura për përfaqësues të institucioneve publike të interesuara, përfaqësues të botës akademike, si dhe partnerë të botës së biznesit. Leksionet u prezantuan nga ekspertët e drejtorive teknike të ASIG, si dhe nga ekspertë të kompanisë GDi - përfaqësuese e ESRI-t në Shqipëri.



Leksione të hapura për studentët

Në datën 16 Nëntor 2023, u zhvilluan leksione të hapura me pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve nga Departamenti i Gjeodezisë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera i Universitetit Politeknik të Tiranës, Departamenti i Gjeografisë në Fakultetin e Histori - Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Këto leksione u prezantuan nga ekspertët e ASIG, përkatësisht nga Drejtoria e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë, si dhe Drejtoria e Përpunimit të Informacionit të Territorit me Teknologji të Avancuara.

Imazheria Satelitore dhe Aplikimet e Saj për Përmirësimin e të Dhënave Gjeohapësinore Kombëtare

Në 10 vjetorin e krijimit të tij, ASIG ka përgatitur katalogun "Imazheria Satelitore dhe Aplikimet e Saj për Përmirësimin e të Dhënave Gjeohapësinore Kombëtare". Ky dokument paraqet teknikat kryesore të procesit të analizës së imazheve satelitore. Shembujt ilustrues janë marrë nga një sërë vendesh dhe kontekstesh për të demonstruar se si rajone të ndryshme të tokës shfaqen në imazhet satelitore.

AKTIVITETE NË VIJIM

GeoAdvances 2024

Qëllimi i këtij workshop-i është shpërndarja e njohurive shkencore globale në fushën e teknologjive të gjeoinformacionit dhe menaxhimit të gjeoinformacionit tek autoritetet lokale dhe organizatat kërkimore, si dhe të veprojë si një urë për përhapjen e zhvillimeve shkencore globale tek vendasit.

11-12 Janar 2024

www.asig.gov.al



AKTIVITETE NË VIJIM

Geodata Discoverability Online Workshop

Eurogeographics dhe EuroSDR organizojnë së bashku një workshop të dytë online të zbulueshmërisë së të dhënave gjeohapësinore. Ky workshop synon shkëmbimin e përvojave praktike, gjetjeve dhe udhërrëfyesve në lidhje me zbulueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore.

16-17 Janar 2024

www.geoportal.asig.gov.al